

## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve

**ID 7.12/k “Përpunimi dhe saldimi i metaleve.”**

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

INTERACTION LTD

Tirana – ALBANIA

**SUBJEKTI: “INTERACTION” SHPK**

NIPT: L21409507U

VENDNDODHJA: Tiranë Vorë VORË në rrugë kryesore, godinë një katëshe,  
përtej urës Vorë - Rinas, Vorë.

## 1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti "INTERACTION" SHPK është regjistruar në QKB me formë ligjore Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me NIPT L21409507U dhe me fushë veprimtarie:

- Importi i hekurit per ndertim dhe katange, (lende e pare hekur per perpunim ne te ftohte).
- Tregetim hekur ndertimi dhe hekur te perpunuar, (zgara, tralice,Hekur i holle i vjaskuar etj), per tregetim brenda vendit dhe eksport.

Subjekti do të nisë procedurën për pajisje me leje mjedis Tip B për aktivitetin **Prodhimi I rrjetave per betonin**, aktiviteti I cili Referuar *shtojces 1 te ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR,* klasifikohet si më poshtë:

**Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve;**

**ID 7.12/k "Përpunimi dhe saldimi i metaleve"**

## 2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
  - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
  - Ndikimi ne flore/faune;
  - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
  - Ndikime social-ekonomike;
  - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
  - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
  - Ndikim ne peizazhin e zones;
- ❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit eshte: Tiranë Vorë VORË në rrugë kryesore, godinë një katëshe, përtej urës Vorë - Rinas, Vorë.

Objekti ku do te zhvillohet aktiviteti eshte ne funksion prej 20 vitesh dhe i vendosur ne zone industriale.

Subjekti "INTERACTION" SHPK posedon kontratë qirjae për pronën në të cilën do të zhvillojë aktivitetin me të dhënat e mëposhtëme:

Pronari	Besnik Selmani Ori Selmani
Numri i Pasurisë	<b>19/72</b>
Zona Kadastrale	<b>2726</b>
Volumi	<b>9</b>
Faqe	<b>175</b>
Sipërfaqja e Pasurisë	<b>3920 m<sup>2</sup></b>
Adresa e pasurisë	<b>Muçaj, Tiranë</b>

Objekti ne dispozicion te perpunimit dhe saldimit te metaleve identifikohet sipas ortofotos se meposhteme:



Koordinatat sipas Gauss Kruger

Nr.	X	Y
1.	4388362.09	4585547.22

#### 4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

##### ID 7.12/k "Përpunimi dhe saldimi i metaleve"

Procesi teknologjik i perpunimit te hekurit ne te ftohte nga lenda e pare katane deri ne produktin perfundimtar (zgara, tralice, Hekur i holle i vjaskuar etj), per tregetim brenda vendit dhe eksport:

a- Lenda e pare, (katanga), vendoset ne nje makineri automatike dhe terhiqet, vjaskohet ne te ftohte ne dimensione te ndryshme qe kerkohen per prodhim.

b- Prerja e hekurit te vjaskuar e te terhequr ne dimensione te ndryshme sipas kerkeses ne makinat e prerjes.

c- Prodhimi i zgarave dhe traliceve.


Me materialet e perfituara ne makinat e prerjes, ne nje makine automatike ne prodhojme zgara me saldim (PIKIM).

Ne gjithe objektin punojne makineri te cilat jane me motor dhe reduktor prej te cilave gjenerohet zhurma, por ne nivele Brenda normave.

Ndertesa (kapanoni), ku jane te vendosura makinerite eshte e mbyllur dhe zhurma eshte minimale.

##### 4.1. Menaxhimi I instalimit

Organograma



Persa i perket struktura se operimit te aktivitetit nga ana e administratorit te shoqerise eshte bere edhe ndarja e detyrave dhe puneve qe do kryeje secili nga punonjesit. Do te jetë nje punonjes i cili do te meret me pjesen financiare dhe me pjesen e menaxhimit, ndersa punonjesit e tjere do te jene pjesa e procesit te aktivitetit.

Tabela e meposhteme jep informacion mbi kushtet e punes.

KUSHTET E PUNËS								
Numri total i punonjësve	13							
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA			
	2	7	1	3	-			
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata 08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>	Instalimet 08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>						
Orët e punës	Zyrat / administrata 8 orë/ditë	Instalimet 8 orë/ditë						
Numri i ditëve të punës në vit	312 ditë/vit							
Numri i orëve në vit	312 ditë x 8 orë = 3249 orë/vit							
Variacionet sezonale	Nuk preket nga varacionet sezonale							
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë varacioneve sezonale Nuk ka	1 turn → 08 <sup>00</sup> -16 <sup>00</sup>	Pjesa tjetër e vittit					
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllt	Pushimet Ndërprerje të rregullta të funksionimit	Dita e dielë është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 20 ditë/pune pushimit në vit. Nuk ka						

#### 4.2. Lëndët e para dhe ndihmëse

Aktiviteti në fjalë është një aktivitet prodhimi, i cili kërkon përdorim të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse si më poshtë:

Lëndë të para	Lëndë/ materiale ndihmëse
Hekur	Ujë
-	Energji Elektrike
-	Mjete/pajisje pune

**Lendet e para** – sigurohen kryesisht ndermjet importit apo furniture te ndryshem. Lenda e pare transportohet me kamione nga furnitoret deri tek magazinat e kompanise.

Ketu shkarkohet dhe magazinohet per perpunimin e metejshem, sipas projekteve perkatese.

Uji do te merret nga rrjeti ndersa **Energjia elektrike** qe do te perdoret per ndricimin e jashtem dhe te brendshem te objektit, gjithashtu edhe per vendosjen ne pune te pajisjeve te punes. Energjia elektrike do te merret nga rrjeti i zones ne baze te kontrates qe operatori ka lidhur me OSHE.

## 5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

### SHKARKIME NE AJER

Ushtrimi I ketij aktiviteti nuk do te ndikoje ne cilesine e ajrit te zones, pasi nuk do te kete shkarkime ne ajer te gazeve, pluhurave apo tymrave. Te vetmet shkarkime ne ajer do te jene ato te cilat vijne si pasoje e mjeteve transportuese te lendet se pare dhe te produktit perfundimtar.

### SHKARKIME NE UJERA

Ushtrimi I ketij aktiviteti nuk do te ndikoje ne ndryshimin e nivelit te ujerave tokesore, ne rruget ujore dhe ne nivelin hidrostatik te ujerave nentokesore, pasi ne kete zone ku ndodhet objekti dhe perreth tij nuk ka burime ujore nentokesore dhe shpime te ndryshme hidrogeologjike qe mund te demtoheshin nga ushtrimi I ketij aktiviteti.

### SHKARKIME NE TOKE

Ushtrimi I aktivitetit te perpunimit dhe saldimit te metaleve nuk sjell ndotje ne toke apo ndryshim te cilesive te saj.

### ZHURMA

Zhurma ne nivele minimale do te gjenerohen nga mjetet e transportit, te cilat perdoren per te transportuar lenden e pare si dhe per transportimin e produktit final tek klientet.

Gjithashtu gjenerim zhurmash mund te kemi nga makinerite e punes. Per kete subjekti ka marre masa duke e pajisur stafin me veshjet perkatese, kufje, ne menyre qe te ruhet shendet i tyre.

Vlen te theksohet se zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti eshte larg qendrave te banuara, keshtu qe nuk ka ndikim ne to.

### MBETJE TE NGURTA

Mbetjet e ngurta dalin si rezultat I aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti

## PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

NIPT L21409507U

vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren konteniere hermetike qe te evidentohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimatike.

### NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negative ne flore apo faune.

### NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

## 6. MONITORIMI

*Qëllimi i monitorimit mjedisor* është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standarde mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazdueshëm.

Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuencia	KUSH?
1.	Monitorim i cilesise se ajrit	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
2.	Monitorim i zhurmave	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
3.	Sasia e mbetjeve te gjeneruara	Ne varesi te punes	Operatori
4.	Sasia e mbetjeve te transferuara	Ne varesi te punes	Operatori
5.	Monitorim I gjendjes teknike te pajisjeve operuese	Cdo 1 vit	Operatori/ teknike te posatshem

